



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR
Letërsia e gjuhës B (2)

Ngarkesa: 4 (katër) kredite; 40 orë mësimore, 20 leksione + 20 orë seminare

Viti / Semestri : Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në degën Gjuhë e Qytetërim Hispanik

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore: Studenti aftësohet të njohë njohë proceset e zhvillimit të historisë së letërsisë spanjolle nga fundshek. XIX deri në shek. XXI. Të lexojë vepra të disa autoreve të ndryshëm, të sugjeruar nga profesori apo dhe zgjedhje e tij e lirë. Studenti komenton tekste letrare dhe shkruan ese mbështetur mbi një mendim analitik.

Objektivat specifike lëndore:

Në fund të kursit studenti është i aftë të:

1. Të njohë lëvizjet artistike më të rëndësishme në letërsi, përfshirë autorët dhe veprat letrare përfaqësuese, përgjatë shekujve XX deri në ditët tona si: Realizmi, Modernizmi, Brezi 98, Vanguardizmi, Brezi 27, Realizmi Ekzistencial e Social, Neorealizmi dhe letërsinë Eksperimentale e Bashkëkohore.
2. Studenti është i aftë të paraqesë një panoramë të letërsisë së kohës në studim në Spanjë dhe ndikimin që kjo letërsi ka nga ajo evropiane dhe hispanike.
3. Ai njeh shkrimtarët përfaqësues të rrymave letrare në studim: si Lorca, Galdos, Jacinto Benavente, etj. dhe librat e tyre përfaqësues të cilët i lexon si literaturë e detyruar dhe prezantohet me literaturën shtesë.
4. Studenti realizon kritikë personale letrare, memorizon poezi të autorëve të ndryshëm, përkthen poezi shkruan ese.
5. Njeh dhe identifikon vepra letrare si përfaqësuese estetikash letrare dhe rrymash artistike.